



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 23.10.2009

Lënda: Njoftim për media

Sot Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi i shoqëruar me këshilltarët e tij vizitoi Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Drejtori i KPMM-së, Azem Rexhaj e njoftoi Kryetarin e Kuvendit për mbarëvajtjen e punëve në mbikëqyrjen e operimeve minerare në Kosovë, për projektet Kryesore të përfunduara deri me tani nga KPMM, për numrin e kompanive të licencuara si dhe problemet me të cilat ballafaqohet KPMM për shkak të mungesë së kompletimit të bordit dhe pamundësinë e marrjes së vendimeve si dhe për problemet ekzistuese në parandalimin e operimeve ilegale në sektorin minerar.

Z. Zenun Elezaj, anëtar i Bordit Qeverisës të KPMM-së bëri një prezantim të resurseve minerale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Z. Shaip Latifi, anëtar i Bordit Qeverisës të KPMM-së diskutoi rreth traditës së Kosovës në zhvillimin e sektorit minerar.

Z. Krasniqi e përgëzoi për punën e madhe që është bërë në KPMM dhe premtoi se do të ketë përkrahje të vazhdueshme nga Kuvendi dhe institucionet tjera ku prioritet do të jetë zgjidhja e anëtarëve të ri të Bordit ose vazhdimi i mandatit të anëtarëve të cilëve u ka skaduar mandati.

Pas takimit me menaxhmentin e lartë të KPMM-së, z. Krasniqi vizitoi edhe departamentet e KPMM-së ku u njoh më për së afërmi me punën e secilit departament.

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo